

## Gjykata e Qarkut në Prishtinë

AP. No. 395/10  
9 dhjetor 2010

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishinë, me Trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it, Gianfranco Gallo, si Kryetari Trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it, Karen Asphaug, dhe gjyqtarja nga Kosova, Fllanza Kadiu, si anëtare të Trupit gjykues, të ndihmuar nga procesmbajtësja, Nexhmije Mejzini, në çështjen penale kundër:

**Tomë Gashit**, i lindur më 14 gusht 1961, në Prishtinë, me adresë aktuale, Rruga "Haradinaj", Prishtinë i cili u shpall fajtor për vepër penale të sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, në kundërshtim me nenin 317, paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1, të KPK-së, nga aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, n. P 514/09, data 28 maj 2009;

pas pranimit të ankesës së ngritur me kohë të pandehurit, më 30 shtator 2010;

pas seancës së mbajtur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, më 7 dhjetor 2010 dhe pas shqyrtimit dhe votimit të mbajtur më 8 dhjetor 2010;

në pajtim me nenin 420, paragrafi 1, pika 2, e KPPK-së, nxjerr sikurse më poshtë:

### AKTGJYKIM

**I. Ankesa e të pandehurit Tomë Gashi refuzohet si e PABAZË.**

**II. Aktgjykimi i Shkallës së Parë P. No. 514/09, data, 28 maj 2010, VËRTETOHET.**

### ARSYETIM

#### 1. Historia Procedurale

Më 19 janar 2007, Prokurori publik ka ngritur Aktakuzën duke e akuzuar Tomë Gashin për vepër penale të sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, në kundërshtim me nenin 317, paragrafët 1 dhe 2, të KPK-së.

Aktakuza ishte konfirmuar me vendimin e Gjyqtarit për konfirmim, më 10 mars 2008, pas seancës për konfirmim.

Me kërkesën e datës 19 mars 2009, Kryetari i Gjykatës Komunale të Prishtinës ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë që gjykimi kundër të akuzuarit të transferohet në një Gjykatë tjetër. Kërkesa ishte bazuar në argumentin se njëri nga të akuzuarit, Z. Tomë Gashi, ishte dikur gjyqtar në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Për të shmangur çdo rrezik të paragjyimit, kërkesa sugjeronte ndryshimin e vendit të gjyqimit.

Me vendimin e datës 27 prill 2009, Kryetari i Gjykatës së Qarkut, në Prishtinë, delegoi Gjykatën Komunale të Ferizajt që të e gjykoj lëndën.

Më 26 qershor 2010, Kryetari i Gjykatës Komunale të Ferizajt, kërkoj nga Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it të i caktoj gjyqtarët e EULEX-it për rastin, duke thënë se për arsye të pozitës së Z. Tomë Gashi, si një këshilltar në Zyrën e Kryeministrit, administrimi si duhet i drejtësisë sugjeroj që rasti të gjykohet nga gjyqtarët ndërkombëtarë.

Me vendimin, data, 17 shtator 2009, pas seancës e paraparë nga neni 4, i Ligjit mbi Juridiksionin, shpërndarja dhe përzgjedhja e rasteve e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it, në Kosovë (L. N. 03/L-053), Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka caktuar rastin për Trupin gjykes të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it.

Gjykimi kryesor kundër të akuzuarit filloj më 14 maj 2010. Pas formaliteteve fillestare dhe leximit të Aktakuzës nga Prokurori publik, filloi marrja në pyetje e dëshmitarëve.

Gjykimi u shty për datat, 25, 27 dhe 28 maj 2010, për marrje të mëtutjeshme në pyetje të dëshmitarëve dhe të të akuzuarit.

Para fillimit të fjalës përfundimtare, Prokurori kërkoi nga Gjykata lejen që të e ndryshoj Aktakuzën sikurse vijon: *“Do të dëshiroja që të e bëj një ndryshim për kualifikimin e veprës penale të sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, në kundërshtim me nenin 317, sipas nenit 317, paragrafi 2, e lidhur me paragrafin 1, të KPPK-së. Do të doja që të e shtoj paragrafin 4”.*

Më 28 maj 2010, Tomë Gashi u shpall fajtor nga Gjykata Komunale në Prishtinë, për veprën penale të sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, në kundërshtim me nenin 317, paragrafi 2, e lidhur me paragrafin 1, të KPK-së, me përjashtim të rrethanës së paragrafit 4 të nenit të lartpërmendur dhe u dënua me gjashtë muaj burgim.

Në pajtim me nenet 43 dhe 44, të KPK-së, dënimi është me kusht.

Më 23 shtator, Aktgjykimi iu dorëzua të pandehurit, i cili, më 30 shtator 2010 e ngriti ankesën kundër vendimit të lartpërmendur, duke kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Dytë që të e lejoj ankesën dhe të e liroj të pandehurin nga akuza.

Më 07 dhjetor 2010 seanca e apelit u mbajt në ndërtesën e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, në praninë e të pandehurit, dhe , më 09 dhjetor pas shqyrtimit dhe votimit, vendimi është lëshuar.

## 2. Meritat.

Ankesa ngriti çështjet sikurse më poshtë:

- A) Gjykata e Shkallës së Parë ka bër shkeljen e parë thelbësore të dispozitës së procedurës penale (neni 403, paragrafi 1, pika 10, e KPK-së), duke e përjashtuar zbatimin e paragrafit 4, të nenit 317, të KPK-së, pavarësisht nga shtesa e bër nga Prokurori gjatë seancës së fundit;
- B) Gjykata e Shkallës së Parë ka bër shkeljen e dytë thelbësore të dispozitës së procedurës penale, sepse dispozitivi ishte i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me Aktgjykimin (neni 403, paragrafi 1, pika 12, e KPK-së);
- C) Gjykata e Shkallës së Parë ka bër shkeljen e tretë thelbësore të dispozitës së procedurës penale, sepse gjatë rrjedhës së procedurës, ekspertiza mjekësore është kryer pavarësisht mungesës së Urdhërit të kërkuar të Gjykatës. Prandaj, Gjykata dhe Prokurori zbatuan padrejtësisht dispozitën e Kodit të Procedurës (neni 403, paragrafi 2, pika 1, e KPK-së). Për më shumë ekspertiza tregoj se lëndimet nuk ishin përshkruar si duhet nga raporti i Qendrës Emergjente.
- D) Gjykata e Shkallës së Parë ka bër shkeljen e katërt thelbësore të dispozitës së procedurës penale, sepse gjatë rrjedhës së procedurës, i pandehuri nuk u lejua që të e paraqes mbrojtjen e tij si duhet (neni 403, paragrafi 2, pikat 1 dhe 2, të KPK-së);
- E) disa deklaratat (në veçanti deklaratat e dhëna nga dëshmitarët, Selman Rexhepi, Dren Hajzeri, Veton Halili, Petrit Dushi dhe Kastriot Berisha), ishin lexuar nga Gjykata, në kundërshtim me dispozitën e nenit 156, paragrafi 2, i KPPK-së, pasi që mbrojtja nuk kishte pasur mundësi që të i ekzaminoj ata;
- F) versioni i dhën nga pala e dëmtuar, Lulzim Borovci, ishte e dyshimtë për arsyet sikurse më poshtë:
  - ishte e dyshimtë dhe e çuditshme se pala e dëmtuar shkoj në spital që të kurohet për lëndimet e tij pas shtatë orëve nga incidenti; kjo hapësirë kohore tregoj se ai i bëri vet gërvishtjet, sepse ai vetëm i kishte shkaktuar lëndime të pandehurit;
  - nuk ishte e vërtetë se i pandehuri ia theu syzet palës së dëmtuar sikurse mund të shihet nga fotografitë në dosje të cilat tregonin se viktimat mbante syze të padëmtuara;
  - Ishte e pavërtetë se i pandehuri ka qëlluar viktimën sikurse mund të shihet nga fakti se uniforma e zyrtarit të policisë nuk ishte shqyer;
  - Ishte e pavërtetë se i pandehuri ishte nën ndikimin e alkoolit dhe në fakt asnjë testim alkooli nuk ishte bërë nga policia.
- G) Aktakuza përmbante mendime personale të Gjykatës sa i përket personalitetit të të pandehurit pa kërkuar Gjykata për ndonjë ekspertizë mbi këtë çështje;
- H) Gjykata ka harruar që të i përmendi mjetet ligjore për të drejtat e ankesës kundër Aktakuzës.

*Në lidhje me pikën A.*

Ankesa është e pabazuar.

Është e padiskutueshme, kur rrethana mund të përjashtoj përgjegjësinë penale është e treguar në Aktakuzë, është në fuqi të Gjykatës që të e vlerësoj nëse rrethana e lartpërmendur është ekzistuese, dhe, në rast të vlerësimit negativ, të e përjashtoj rrethanën.

Është saktësisht se çfarë ka ndodhur në rastin e tanishëm: në fakt prokurori pati qëndrimin se i pandehuri ishte provokuar nga veprime të paligjshme dhe brutale nga viktimja, por, Gjykata e Shkallës së Parë, pasi që ky version, i përkrahur vetëm nga deklaratat e dhëna nga Tomë Gashi, dhe nga bashkë i pandehuri tjetër, nuk mori ndonjë vërtetim nga dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët (të cilët në të vërtet kanë përjashtuar ndonjë provokim), ligjshmërisht ka vendosur që të përjashtoj dispozitën e paraparë në nenin 317, paragrafin 4, të KPK-së, duke e vlerësuar se nuk kishte dëshmi të provokimit kundër ankuesit (apo të të pandehurve të tjerë).

Është e qartë se një vlerësim i tillë nuk ka asgjë të bëjë me shkelje të parashikuara me nenin 403, paragrafi 1, pika 10, e KPPK-së; dispozita e lartpërmendur i referohet rastit në të cilin Aktgjykimi shkon përtej akuzës duke shtuar elemente faktike, të cilat nuk ishin përmendur në Aktakuzë, në dëm të të pandehurit.

Për shembull, rasti tipik i tejkalimit të qëllimit të Aktakuzës do të ishte atëherë kur Gjykata, pavarësisht se i pandehuri ishte akuzuar për vjedhje dënon të pandehurin për grabitje, pa dalë me ndonjë rrethanë të dhunës.

Në të kundërtën, është kryekëput në forcat e Gjykatës që të vendos nëse rrethana të tilla ishin provokime të viktimës në të vërtet ndodhën.

Zgjedhja e kundërt do të sjellë atë, në rast se Aktakuza tregon rrethana sikurse e paraparë me nenin 317, paragrafi 4, i KPK-së, Gjykata do të e lidhë me kualifikimin e Prokurorit dhe nuk do të ishte e aftë që të vlerësoj nëse rrethana e tillë ekziston. Situatë hipotetike e cila qartazi bie në konflikt me dispozitën e nenit 386, të KPPK-së.

*Lidhur me pikën B.*

Ankesa është e pabazuar.

Pohimi se dispozitivi është i pakuptueshëm dhe absolutisht apodiktike, pasi që apeluesi nuk e shpjegon se pse dispozitivi do të ishte i pamundur që të kuptohet dhe në kundërshtim me arsyetimin.

Në të kundërtën, dispozitivi shfaqet në tërësi në pajtim me kërkesat e neneve 391 dhe 393, të KPPK-së dhe në përputhje me arsyetimin e cila jep shpjegime logjike dhe të detajuara të arsyeve se pse Tomë Gashi është shpallur fajtor.

*Në lidhje me pikën C.*

Ankesa është e pabazuar.

Ndryshe nga është thënë nga i pandehuri, në dosje nuk është ekspertiza lidhur me lëndimet e marra nga pala e dëmtuar, Lulzim Borovci. Ekspertiza e vetme është ajo e lidhur me lëndimet nga Avni Zogiani.

Dhe në fakt, në Aktgjykim të Gjykatës së Shkallës së Parë nuk ka referencë lidhur me ekspertizën në lidhje me lëndimet e Borovcit.

Prandaj, del se apeluesi gabimisht supozoj se një ekspertizë e tillë ekzistonte.

Në çdo rast, neni 237, paragrafi 2, i KPPK-së, tregon shprehimisht analizat e ekspertit të cilat kërkojnë urdhrin e Gjykatës: ekzaminimi fizik, në rast se nuk do të sjellë ndërhyrje trupore, nuk është në listë, në mesin e kësaj kategoria.

Në të vërtet, neni 237, shprehimisht përjashton që një ekzaminim i tillë kërkon urdhër të Gjykatës (në fakt urdhri i thjesht i Prokurorit është i mjaftueshëm, sikurse që parashihet me nenin 236, të KPPK-së).

Pra, edhe pse një ekspertizë lidhur me lëndimet e marra nga Lulzim Borovci kanë ekzistuar dhe janë kryer në bazat e urdhrin të thjesht të Prokurorit, asnjë shkelje e procedurës nuk do të ndodhte.

*Në lidhje me pikën D.*

Ankesa është e pabazuar.

Është e vërtet se nga procesverbalet na shfaqet se ndonjëherë Kryetari i Trupit gjykues kërkon vëmendje të të pandehurve si të nevojshme që gjykimi të procedoj, por kjo bie në tërësi brenda autoritetit të Kryetarit të Trupit gjykues e parashikuar në nenet 332-335, të KPPK-së.

Në të kundërtën, nga procesverbali i shqyrtimit kryesor na del se të drejtat e mbrojtjes nuk ishin shkelur dhe të pandehurit i ishin dhënë mundësi që të bëjë të gjitha pyetjet e rëndësishme.

*Në lidhje me pikën E.*

Ankesa është e pabazë.

Në procesverbal (faqe 3), të seancës së 27 majit 2010, qartë tregohet se palët, në pajtim me nenin 368, paragrafi 1, pika 3, e KPPK-së, kanë dhënë pëlqimin e tyre lidhur me zëvendësimin e ekzaminimit të dëshmitarëve të lartpërmendur duke i lexuar deklaratat e tyre të mëparshme (në të vërtet, deklaratat ishin konsideruar si të lexuara në bazë të pëlqimit të palëve).

Është e qartë se neni 368, i KPPK-së paraqet një përjashtim tek dispozita e paraparë me nenin 156, paragrafi 2, i KPPK-së, dhe atë nëse deklaratat është siguruar në pajtim me kushtet e parashikuara nga neni 368, i KPPK-së, duhet që të konsiderohet si dëshmi e pranueshme.

Në rastin e paraparë nga neni 368, paragrafi 1, pika 3, e KPPK-së, është e qartë se duke e dhën pëlqimin, mbrojtja qartazi heq dorë nga të drejtat e marrjes në pyetje dëshmitarin. Prandaj, asnjë shkelje në procedurën nuk është kryer nga Gjykata e Shkallës së Parë.

*Në lidhje me pikën F.*

Ankesa është e pabazuar.

Konkluzioni i bër nga apeluesi, se, pasi që viktima shkoi në spital shtatë orë pas incidentit, nuk ka pasur ndonjë lëndim është e pa demonstruar dhe e pa provuar.

Në të kundërtën, dëshmitë konvergjente të zyrtarëve të policisë që intervenuan menjëherë, qartë kanë përmendur agresionin fizik të ndërmarr nga Gashi kundër zyrtarëve të policisë.

Dhe se Borovci kishte sulmuar të pandehurin është treguar nga fotografitë në dosje; në fakt, ndryshe nga çfarë i pandehuri ka thënë, uniforma e zyrtarit të policisë zhurmshëm ishte shqyer (shiko mëngën, deri tek sqetulla dhe xhepi në gjoks, në faqen 62/71, të dosjes), syzet ishin thyer (shiko fotografitë në faqet 72/71) dhe është një lëndim i lehtë trupor ( skuqje në lëkur), në qafë.

Të thuash se e tëra kjo është bërë nga zyrtarët e policisë është vetëm një supozim i të pandehurit dhe mohohet nga fakti se viktima në të vërtet ishte sulmuar nga Gashi.

Në fund, është e qartë se zyrtarët e policisë mund të e vlerësojnë nëse një person është nën ndikimin e alkoolit, madje edhe pa ndonjë testim të alkoolit; në fakt gjendja e dehjes mund të shkaktohet nga çdo element i dehjes (ca nga ata kanë qenë të treguar qartë nga dëshmitarët).

*Në lidhje me pikën G.*

Ankesa është e pabazuar.

Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka bër ndonjë vlerësim mbi personalitetin e të pandehurit por thjesht ka konkluduar nga sjellja e mbajtur nga i pandehuri gjatë shqyrtimit kryesor se një agresivitet në drejtim të policisë e kryer, ishte në përputhje me karakterin e treguar nga i pandehuri përgjatë shqyrtimit kryesor.

Madje fjalët e përdorura nga Gjykata e Shkallës së Parë mund të vihet në pyetje, asnjë shkelje e procedurës mund të gjendet.

*Lidhur me pikën H.*

Ankesa është e pabazuar.

Është e vërtet se arsyetimi nuk përmban ndonjë shenjë të mjeteve ligjore, por në anën tjetër i vetmi obligim për Kryetarin e Trupit gjykues është që të i udhëzoj palët lidhur me të drejtat e ankesës (neni 394, paragrafi 1, i KPPK-së). Udhëzimet e lartpërmendura u janë dhënë palëve sikurse rezulton nga procesverbali i datës, 28 maj 2010, faqe 4.

Prandaj, asnjë shkelje e procedurës nuk është bërë, nga Gjykata e Shkallës së Parë.

\* \* \*

Në fund, duhet që të vlerësohet se vlerësimi i provave e bërë nga Gjykata e Shkallës së Parë ishte e ekuilibruar, ferr dhe nuk ka dyshime, të dyja në lidhje me *actus reus* dhe *mens rea*, sa i përket fajësisë së të pandehurit.

Për më shumë, asnjë shkelje thelbësore e procedurës penale dhe të ligjit penal që duhet të ngritet *ex officio* nuk është gjetur nga Gjykata e Shkallës së Dytë.

Me anën e kësaj është vendosur sikurse në dispozitiv.

Kryetari i Trupit Gjykuës  
Gianfranco Gallo

Anëtar i Trupit Gjykuës  
Karen Aspöhaug



Anëtar i Trupit Gjykuës  
Fllanza Kadiu

Procesmbajtëse  
Nexhmije Mejzini